




REC
Shqipëri

17 OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM PËR TRANSFORMIMIN E BOTËS



SENIOR II

Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



17

OBJEKTIVAT E OKB-SË PËR TRANSFORMIMIN E BOTËS

17 objektiva konkretë të shoqëruar me 169 tregues të synuar

**SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
GOALS**

Ky botim është mbështetur nga:



Në kuadër të programit:



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

përgatitur nga:



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore (REC) është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse me mision mbështetjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore e Lindore (EQL). Qendra e përmbush misionin e saj duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore. REC është krijuar në 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Sot REC bazohet ligjërisht në Kartën e REC, nënshkruar nga 30 vende dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. Në Shqipëri, REC është regjistruar si entitet ligjor dhe ka zyrën e saj që prej vitit 1993. Si pjesë e rrjetit të zyrave lokale të REC në Evropën Jug-Lindore, REC Shqipëri punon për të përmbushur misionin e REC përmes mbështetjes së OJFve, të institucioneve mjedisore në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe të aktorëve të ndryshëm që veprojnë në fushën e mjedisit. Gjithashtu, REC Shqipëri promovon pjesëmarrjen publike dhe shkëmbimin e informacionit.

Donatorët më të fundit janë Komisioni Evropian, dhe qeveritë e Suedisë, Austrisë, Gjermanisë, Hungarisë, Italisë, Japonisë, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, si dhe organizata të tjera ndërqeveritare dhe institucione private.

Asnjë pjesë e këtij botimi
nuk mund të përdoret për qëllime përfitimi apo publikimi pa leje me shkrim të
Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Shqipëri



PARATHËNIE

Programi i ri “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR-II)”, si vazhdimësi e programit të mëparshëm në mbështetje të shoqërisë civile shqiptare, synon të fuqizojë më tej shoqërinë civile në fushën e mjedisit, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore shqiptare dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Forcimi i shoqërisë civile kërkon një investim domethënës dhe afatgjatë, jo vetëm në mbështetjen me fonde, por dhe në rritjen e kapaciteteve të organizatave, si në aftësitë bazë ashtu dhe në ato të lidhura me sektorë të veçantë të mjedisit.

Përgjatë zbatimit të programit SENIOR-II, krahas aktiviteteve kryesore adresuar organizatave të shoqërisë civile (p.sh mbështetja me fonde/grante; dhënien e trajnimeve tematike; mundësimi i rrjetëzimeve mes tyre etj.), është parashikuar dhe publikimi i disa moduleve tematike me një temë të veçantë për çdo botim. Këto module, përmes koncepteve të reja dhe informacionit të plotë që do të përcjellin, mund të shërbejnë si material burimor për Organizatat e Shoqërisë Civile në punën e tyre të përditshme.

Duke i shërbyer dhe qëllimit kryesor të programit, ky modul tematik adreson, në mënyrë të veçantë, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është i gjerë dhe kompleks, ai prek të gjitha sferat e shoqërisë, duke harmonizuar nevojat e zhvillimit ekonomik dhe atij social, duke mbajtur gjithmonë parasysh kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë aspekt, ky publikim kontribuon në njohjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, për t’i përkthyer ato në elementë praktikë pune nga individët, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset në vend.



HYRJE



Programi për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 është një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe mirëqënien.

Ky program synon të forcojë paqen universale në shkallë më të gjerë. Ne e dimë që është sfida më e madhe globale zhdukja e varfërisë në të gjitha format dhe dimensionet e saj por është dhe një kërkesë e domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm.

Të gjitha vendet dhe palët e interesuara, që veprojnë në partneritet bashkëpunues, duhet ta zbatojnë këtë plan. Ne jemi të vendosur të çlirojmë shoqërinë njerëzore nga tirania e varfërisë dhe të ndërtojmë një planet të sigurtë. Ne jemi të vendosur të ndërmarrim hapa të guximshëm dhe transformues, të cilët janë mëse të nevojshëm për të ndryshuar botën në një vend më të sigurtë dhe me zhvillim të qëndrueshëm. Pasi ne të fillojmë këtë udhëtim kolektiv, zotohemi se askush nuk do të lihet pasdore.

17 Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ) dhe 169 treguesit e synuar tregojnë ambicien e këtij programi universal. Këto objektiva janë ndërtuar mbi themelin e hedhur nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe plotësojnë atë çka nuk u arrit në kuadër të OZHM-ve.

Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm bazohen në plotësimin e të drejtave të njeriut, në arritjen e barazisë gjinore dhe në fuqizimin e rolit të grave dhe vajzave në shoqëri. Ato përfshijnë në mënyrë të pandashme dhe të ekuilibruar tre dimensionet e Zhvillimit të Qëndrueshëm: dimesionin ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.



Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm dhe treguesit e synuar do të nxisin veprimin për gjatë 15 viteve të ardhshëm në sektorët me rëndësi kritike për njerëzimin dhe planetin:

Për njerëzit

Jemi të vendosur ti japim fund varfërisë dhe urisë, në të gjitha format dhe dimensionet, dhe të sigurohemi që mirëqënia e individëve do të përmbushë potencialin e tyre me dinjitet dhe barazi në një mjedis të shëndetshëm.

Planeti

Jemi të vendosur të mbrojmë planetin nga degradimi, duke përfshirë konsum dhe prodhim të qëndrueshëm, menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe duke ndërmarrë veprime urgjente për ndryshimet klimatike, duke ndihmuar në plotësimin e nevojave të së tashmes dhe brezit të ardhshëm.

Mirëqënia

Jemi të vendosur t'iu sigurojmë qenieve të gjithë qenieve njerëzore një jetë të begatë dhe të përmbushur, dhe një progres ekonomik, shoqëror dhe teknologjik në harmoni me natyrën.

Paqja

Jemi të vendosur të edukojmë individët për paqen, për një shoqëri të lirë nga frika dhe dhuna. Nuk mund të ketë një Zhvillim të Qëndrueshëm pa paqe dhe nuk mund të ketë paqe pa një Zhvillim të Qëndrueshëm.

Bashkëpunimi

Jemi të vendosur për të mobilizuar mjetet e nevojshme për të zbatuar këtë program nëpërmjet një Bashkëpunimi Global për Zhvillimin e Qëndrueshëm, i bazuar në shpirtin e bashkëpunimit global, i fokusuar në nevojat e veçanta të varfërisë dhe me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve, palëve të interesuara dhe individëve.

Ndërlidhjet dhe natyra e integruar e Objektivave të Zhvillimin e Qëndrueshëm kanë një rëndësi të madhe për të siguruar realizimin e objektivave të këtij programi. Nëse kemi përmbushur ambiciet tona në çdo drejtim të këtij programi, jeta e të gjithëve do të përmirësohet thellësisht dhe puna jonë do të transformohet për mirë.



1

PA VARFËRI



ELEMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË
VARFËRISË

- 1.1 Deri në vitin 2030, të zhduket varfëria ekstreme për të gjithë njerëzit kudo, e matur aktualisht me numrin e njerëzve që jetojnë sot me më pak se 1.25 \$ në ditë.
- 1.2 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet të paktën përgjysëm përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave, që jetojnë në varfëri, në të gjitha dimensionet e saj, në bazë të përcaktimeve kombëtare.
- 1.3 Të zbatohen sistemet dhe masat e përshtatshme kombëtare të mbrojtjes sociale për të gjithë, përfshirë dhe shtresat e ulëta, dhe deri në vitin 2030 të arrihet një mbulim i konsiderueshëm i njerëzve të varfër dhe të pambrojtur.
- 1.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë burrat dhe gratë, në veçanti njerëzit e varfër dhe të pambrojtur, të kenë të drejta të barabarta në përdorimin e burimeve ekonomike, si qasje në shërbimet minimale, pronësi dhe kontroll mbi tokën, si dhe në forma të tjera të pronësisë, të trashëgimisë, të burimeve natyrore, të teknologjive të reja të përshtatshme dhe të shërbimeve financiare, përfshirë dhe mikrofinancat.
- 1.5 Deri në vitin 2030, të rriten aftësitë për të përballuar situatat e pafavorshme prej të varfërve dhe të atyre që jetojnë në gjendje të vështirë dhe të zvogëlohet ekspozimi dhe cënueshmëria e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore.
 - 1.a Të sigurohet përdorimi i plotë i burimeve të ndryshme, edhe përmes një bashkëpunimi më të fortë për zhvillim, në mënyrë që të sigurohen mjetet e duhura dhe të parashikueshme për vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, për të zbatuar programe dhe politika me qëllim dhënien fund varfërisë në të gjitha dimensionet e saj.
 - 1.b Të krijohen korniza të shëndetshme politikash në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në strategji zhvillimi pro të varfërve dhe me ndjeshmëri gjinore, për të mbështetur investime të përshpejtuara për çrrënjosjen e varfërisë.

*Nuk ka rëndësi sa shumë jemi të angazhuar të bëjmë,
por sa shumë dashuri vendosim në të.*

Nënë Tereza


2

ZERO

URI



ELEMINIMI I URISË, ARRITJA E SIGURISË
USHQIMORE DHE E PËRMIRËSIMIT TË
USHQYERJES DHE NXITJA E BUJQËSISË
SË QËNDRUESHME



- 2.1 Deri në vitin 2030, të eleminohet uria dhe të sigurohet e drejta e të gjithë njerëzve, në veçanti e të varfërve dhe e atyre që jetojnë në gjendje të vështirë, përfshirë foshnjat, për të patur ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit.
- 2.2 Deri në vitin 2030, të eleminohen të gjitha format e kequshqyerjes, përfshirë edhe arritjen, deri në 2025-ën, të treguesve të miratuar ndërkombëtarisht lidhur me frenimin e zhvillimit të fëmijëve nën 5 vjeç dhe të adresohen nevojat për ushqim të vajzave adoleshente, të grave shtatzëna dhe atyre që ushqejnë foshnjat me gji, si dhe të personave të moshuar.
- 2.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve ushqimorë në shkallë të vogël, veçanërisht e grave, popujve indigjenë, familjeve fermere, blegtorëve dhe peshkatarëve, përfshirë edhe përmes qasjes së sigurt dhe të barabartë tek toka, burimet e tjera prodhuese, njohuritë, shërbimet financiare, tregjet dhe mundësitë për shtimin e vlerës dhe punësimin jashtë sektorit bujqësor.
- 2.4 Deri në vitin 2030, të sigurohen sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika ripërtëritëse bujqësore që rrisin red dhe prodhimin, ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve, forcojnë kapacitetin për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirave, përmblytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që në mënyrë progresive përmirësojnë cilësinë e tokës bujqësore dhe të dheut.
- 2.5 Deri në vitin 2020, të ruhet shumëllojshmëria gjenetike e farave, e bimëve të kultivuara dhe të rritura në ferma dhe e kafshëve të zbutura dhe llojet e tyre të egra, përfshirë dhe përmes menaxhimit në mënyrë korrekte dhe të shumëllojshme të bankave të farërave dhe bimëve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, dhe të përkrahet qasja për të patur dhe për të ndarë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë përfitimet që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike dhe të shoqëruara me njohuri tradicionale, siç janë miratuar ndërkombëtarisht.
- 2.a Të rriten investimet, përfshirë edhe përmes përmirësimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, në infrastrukturën rurale, në kërkimet bujqësore dhe shërbimet shtesë, në zhvillimin e teknologjisë dhe të bankave gjenetike të bimëve dhe gjësë së gjallë, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve bujqësore prodhuese në vendet në zhvillim, e në veçanti në vendet më pak të zhvilluara.



- 2.b Të korrighohen dhe të parandalohen kufizimet tregtare dhe shtrembërimet në tregjet bujqësore në botë, përfshirë edhe përmes eliminimit paralel të të gjitha formave të subvencioneve të eksportit bujqësor dhe të të gjitha masave të eksportit me efekt të barazvlefshëm, në përputhje me mandatin e Programit të Zhvillimit Doha (Doha Development Round).
- 2.c Të miratohen masat për të siguruar funksionimin e duhur të tregjeve të mallrave ushqimore dhe derivateve të tyre dhe për të lehtësuar marrjen në kohë të informacionit mbi tregun, përfshirë dhe informacionin për rezervat ushqimore, me qëllim që të ndihmohet në kufizimin maksimal të paqëndrueshmërisë së çmimeve në tregun ushqimor.

*Kam zgjedhur varfërinë për njerëzit tanë të varfër.
Por jam e nderuar të marr çmimin Nobel në emër të urisë,
në emër të të pastrehëve, të verbërve, të sëmurëve,
të atyre njerëzve që janë të padëshiruar,
që nuk i do dhe nuk kujdeset njeri.
Njerëzit që ndihen të braktisur nga shoqëria,
dhe të refuzuar nga të gjithë.*
Nënë Tereza




3

SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE



SIGURIMI I JETËS SË SHËNDETSHME
DHE NXITJA E MIRËQENIES PËR TË
GJITHË NJERËZIT E ÇDO MOSHE



- 3.1 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet raporti global i vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 vdekje për 100,000 lindje.
- 3.2 Deri në vitin 2030, të parandalohen vdekjet e të porsalindurve dhe e fëmijëve nën moshën 5 vjeç, ku të gjitha vendet të synojnë zvogëlimin e vdekshmërisë të të porsalindurve në më pak se 12 vdekje për 1,000 lindje dhe të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç në më pak se 25 vdekje për 1,000 lindje.
- 3.3 Deri në vitin 2030, të eliminohen epidemitë e SIDA-s, të tuberkulozit, të malaries dhe të sëmundjeve tropikale të neglizhuara dhe të luftohet hepatiti, sëmundjet që transportohen përmes ujit dhe sëmundjet e tjera ngjitëse.
- 3.4 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet me një të tretën vdekshmëria tek lindjet e parakohshme si pasojë e sëmundjeve jo të transmetueshme, përmes parandalimit dhe trajtimit dhe promovimit të shëndetit mendor dhe të mirëqenies.
- 3.5 Të forcohet parandalimi dhe trajtimi i personave që abuzojnë me me lëndët narkotike dhe alkoolin.
- 3.6 Deri në vitin 2020, të përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe i plagosjeve nga aksidentet rrugore.
- 3.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasja e gjithanshme në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, përfshirë dhe planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, dhe futjen e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare.
- 3.8 Të arrihet mbulimi i gjithëanshëm shëndetësor, përfshirë mbrojtjen financiare të riskut, qasjen në shërbimet bazë cilësore të kujdesit shëndetësor dhe qasjen ndaj barnave dhe vaksinave kryesore të sigurta, efikase, cilësore dhe të përbalueshme për të gjithë.
- 3.9 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet dukshëm numri i vdekjeve dhe i sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe nga ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokës.
- 3.a Të forcohet zbatimi i Konventës Kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e konsumit të duhanit, sipas rastit, në të gjitha vendet.



- 3.b Të mbështetet kërkimi dhe zhvillimi i vaksinave dhe i barnave për sëmundjet e transmetueshme dhe jo të transmetueshme, të cilat prekin, kryesisht, vendet në zhvillim, të sigurohet përdorimi i barnave dhe i vaksinave të rëndësishme dhe të përballueshme, në përputhje me Deklaratën e Dohas mbi Marrëveshjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale për Çështjet lidhur me Tregtinë (TRIPS) dhe Shëndetin Publik, e cila konfirmon të drejtën e vendeve në zhvillim për të përdorur plotësisht dispozitat e Marrëveshjes TRIPS në lidhje me lehtësitë për të mbrojtur shëndetin publik, dhe në veçanti, për të siguruar përdorimin e barnave për të gjithë.
- 3.c Të rriten, ndjeshëm, financimet për shëndetësinë, për rekrutimin, për zhvillimin, për trajnimin dhe për mbështetjen e punonjësve në sektorin shëndetësor në vendet në zhvillim, e në veçanti në vendet më pak të zhvilluara dhe në shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim.
- 3.d Të forcohen kapacitetet e të gjitha vendeve, veçanërisht e vendeve në zhvillim, për paralajmërimin e hershëm, zvogëlimin e rrezikut dhe menaxhimin e rreziqeve shëndetsore në nivel kombëtar dhe global.

Ka barna dhe mjekime për çfarëdolloj sëmundje.

*Por nuk ka duar të mira që t'u shërbejnë
dhe zemra bujare që të dashurojnë*


Nënë Tereza




4 ARSIM CILËSOR



SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR
GJITHËPËRFSHIRËS DHE TË BARABARTË
DHE NXITJA E MUNDËSIVE PËR EDUKIM
GJATË GJITHË JETËS PËR TË GJITHË



- 4.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimimin fillor dhe 9 vjeçar pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, që çon në rezultate të rëndësishme dhe efikase të të mësuarit.
- 4.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë kanë të drejtë për zhvillim cilësor që në fëmijërinë e hershme, për përkujdesje dhe për edukim para-shkollor, në mënyrë që të jenë gati për arsimim fillor.
- 4.3 Deri në vitin 2030, të sigurohen qasje të barabartë për të gjithë gratë dhe burrat që të ndjekin arsimin profesional, teknik apo atë universitar me kosto të përballeshme dhe cilësor.
- 4.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet rritje e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të të rriturve që kanë aftësitë e nevojshme, përfshirë aftësitë teknike dhe ato profesionale, për t'u punësuar, për punë cilësore dhe për sipërmarrje.
- 4.5 Deri në vitin 2030, të eliminohet pabarazia gjinore në arsim dhe të sigurohet qasje e barabartë në të gjitha nivelet e arsimimit dhe të trajnimit profesional për grupet më të ndjeshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe fëmijët e pambrojtur.
- 4.6 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë të rinjtë dhe një pjesë e konsiderueshme e të rriturve, burra dhe gra, të arrijnë të shkruajnë dhe të lexojnë.
- 4.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë nxënësit të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar Zhvillimin e Qëndrueshëm, përfshirë, ndër të tjera, Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe një mënyrë jetese të qëndrueshme, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, përkrahjen e kulturës së paqes dhe jo të dhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin ndaj shumëllojshmërisë së kulturave dhe të kontributit që jep kultura për Zhvillimin e Qëndrueshëm.
- 4.a Të ndërtohen dhe të përmirësohen objektet arsimore të përshtatshme për fëmijët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për ndjeshmërinë gjinore dhe të sigurohen mjedise të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive në të mësuar për të gjithë.



- 4.b Deri në vitin 2020, të shtohet ndjeshëm numri i bursave për të ndjekur arsimin e lartë, në nivel global, në dispozicion për vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim dhe vendet afrikane, përfshirë shkollimin profesional, teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, programet teknike, inxhinierike dhe shkencore, në vendet e zhvilluara dhe në vendet e tjera në zhvillim.
- 4.c Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm numri i mësuesve të kualifikuar, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar për trajnimin e mësuesve në vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim.

Disa njerëz vijnë në jetë si bekim.

Disa të tjerë vijnë si mësim.

Nënë Tereza




5

BARAZI GJINORE



ARRITJA E BARAZISË GJINORE DHE
FUQIZIMI I TË GJITHA GRAVE DHE
VAJZAVE

- 
- 5.1 T'i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave.
 - 5.2 Të eleminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.
 - 5.3 Të eleminohen të gjitha praktikat e dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme dhe martesat e detyruar dhe gjymtimi gjenital femëror.
 - 5.4 Të njihet dhe të vlerësohet kujdesi dhe puna shtëpiake pa pagesë, përmes dhënies së shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale dhe përkrahjes së përgjegjësive të përbashkëta brenda shtëpisë dhe familjes, në përputhje me praktikat kombëtare.
 - 5.5 Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe dhënia e mundësive të barabarta për udhëheqjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.
 - 5.6 Të sigurohet qasja e gjithanshme në shëndetin seksual dhe atë riprodhues dhe në të drejtat riprodhuese, siç është rënë dakord, në përputhje me Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe me Platformën për Veprim të Pekinit dhe dokumentet e tjera rezultat i konferencave të zhvilluara.
 - 5.a Të ndërmerren reforma për t'i dhënë grave të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike dhe të drejta pronësie dhe kontrolli mbi tokën dhe forma të tjera të pronësisë, të shërbimeve financiare, të trashëgimisë dhe burimeve natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare.
 - 5.b Të përkrahet fuqizimi i grave duke rritur përdorimin e teknologjisë, në veçanti teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.
 - 5.c Të miratohen dhe të forcohen politikat e shëndosha dhe legjislacioni i zbatueshëm në përkrahjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

Nëse i gjykoni njerëzit, nuk keni kohë t'i doni ata.

Nënë Tereza





6

UJË I PASTËR DHE KANALIZIME




SIGURIMI I FURNIZIMIT DHE I
MENAXHIMIT TË QËNDRUESHËM TË
UJIT DHE KANALIZIMEVE PËR TË GJITHË


- 
- 6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përbalueshëm për të gjithë;
 - 6.2 Deri në vitin 2030, të mundësohet qasje në sistemin e kanalizimeve dhe të higjienës të përshtatshme dhe të barabartë për të gjithë dhe t'i jepet fund jashtëqitjeve në hapësira të hapura, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe personave që janë në gjendje të pambrojtur.
 - 6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global.
 - 6.4 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm përdorimi efikas i ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqja e qëndrueshme e tij dhe furnizimi me ujë të pijshëm për të adresuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit.
 - 6.5 Deri në vitin 2030, të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkufitar sipas rastit.
 - 6.6 Deri në vitin 2020, të mbrohen dhe të rigjenerohen ekosistemet ujore, përfshirë dhe malet, pyjet, luginat, lumenjtë, ujërat nëntokësore dhe liqenet.
 - 6.a Deri në vitin 2030, të zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetja për ngritjen e kapaciteteve në vendet në zhvillim lidhur me aktivitete dhe programe për ujin dhe kanalizimet, përfshirë dhe grumbullimin e ujit, shkripëzimin, eficiencën e përdorimit të ujit, trajtimin e ujërave të zeza, teknologjitë e riciklimit dhe të ripërdorimit.
 - 6.b Të mbështetet dhe të forcohet pjesëmarrja e komuniteteve vendore në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe të kanalizimeve.
- 

7

ENERGJIE PËRBALLUESHME DHE E PASTËR




SIGURIMI I LIDHJES ME ENERGJI TË
PËRBALLUESHME, TË SIGURT, TË
QËNDRUESHME DHE MODERNE
PËR TË GJITHË

- 
- 7.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e përgjithshme në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë.
 - 7.2 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm pjesa që zë energjia e rinovueshme në totalin e energjisë së përftuar nga burime të ndryshme në nivel global.
 - 7.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet norma globale e përmirësimit të eficiencës së energjisë.
 - 7.a Deri në vitin 2030, të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar për të lehtësuar qasjen në kërkimin dhe teknologjinë për energji të pastër, përfshirë energjinë e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe teknologjitë e përparuara dhe të pastra që përdorin lëndë djegëse fosile, dhe për të përkrahur investimet në infrastrukturën energjetike dhe teknologjinë për energji të pastër.
 - 7.b Deri në vitin 2030, të zgjerohet infrastruktura dhe të përmirësohet teknologjia për furnizimin e shërbimeve moderne dhe të qëndrueshme të energjisë për të gjithë njerëzit në vendet në zhvillim, e veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara, shteteshuj të vegjël në zhvillim, si dhe vendet në zhvillim pa dalje në det, në përputhje me programet e tyre përkatëse për mbështetje.

*Fjalët e mira mund të jenë të shkurtra dhe të lehta për t'u thënë,
por jehona e tyre është vërtet e pafund.*

Nënë Tereza




8

PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE



NXITJA E RRRITJES EKONOMIKE TË
VAZHDESHME, GJITHËPËRFSHIRËSE
DHE TË QËNDRUESHME, PUNËSIM TË
PLOTË DHE PRODUKTIV DHE PUNË TË
DENJË PËR TË GJITHË



- 8.1 Të mbështetet rritja ekonomike për frymë në përputhje me kushtet kombëtare dhe, në veçanti, për vendet më pak të zhvilluara kjo rritje të jetë të paktën 7 % e prodhimit të brendshëm bruto në vit.
- 8.2 Të arrihen nivele më të larta të prodhimtarisë ekonomike përmes shumëllojshmërisë, përmirësimit teknologjik dhe risive, duke përfshirë fokusimin në rritjen e vlerës së shtuar dhe sektorët e punës intensive.
- 8.3 Të përkrahen politika të orientuara në zhvillim, që mbështetin aktivitetet prodhuese, krijimin e vendeve të denja të punës, sipërmarrjen, krijimtarinë dhe risitë dhe të nxitet formalizmi dhe rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë edhe qasjes tek shërbimet financiare.
- 8.4 Të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, deri në vitin 2030, efica e burimeve globale për konsum dhe prodhim dhe të synohet ndarja e rritjes ekonomike nga degradimi i mjedisit, në përputhje me kuadrin 10 vjeçar të programeve për konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, ku vendet e zhvilluara marrin rolin udhëheqës në këtë proces.
- 8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denja për të gjithë gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagesë të barabartë për punën me vlerë të njëjtë.
- 8.6 Deri në vitin 2020, të zvogëlohet ndjeshëm përqindja e të rinjve të papunë, të paarsimuar apo të patrajtuar.
- 8.7 Të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sigurohet ndalimi dhe eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve, përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve si ushtarë, dhe deri në vitin 2025 t'i jepet fund punës së fëmijëve në të gjitha format e saj.
- 8.8 Të mbrohen të drejtat për punë dhe të mundësohen mjedise pune të sigurt për të gjithë punëtorët, përfshirë punëtorët emigrantë, e në veçanti gratë emigrante, dhe ata që punojnë në punë jo të sigurta.
- 8.9 Deri në vitin 2030, të hartohen dhe të zbatohen politika për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm, që krijon vende pune dhe përkrah kulturën dhe produktet vendase.



- 8.10 Të forcohen kapacitetet e institucioneve financiare vendase për të nxitur dhe për të zgjeruar qasjen ndaj sektorit bankar, sigurimeve dhe shërbimeve financiare për të gjithë.
- 8.a Të rritet mbështetja e Ndihmës për Tregti për vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, përfshirë edhe përmes Kornizës Kuadër të Zgjeruar dhe të Integruar për Ndihmë Teknike lidhur me Tregëtinë për vendet më pak të zhvilluara.
- 8.b Deri në vitin 2020, të zhvillohet dhe të funksionojë një strategji globale për punësimin e të rinjve dhe të zbatohet Pakti Global për Punësimin, i Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

*Unë bëj gjëra që ju nuk mund t'i bëni,
ju bëni gjëra që unë nuk mund t'i bëj,
së bashku bëjmë gjëra të mëdha.*

Nënë Tereza




9

INDUSTRI, NOVACION DHE INFRASTRUKTURË




NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS
REZISTENTE, NXITJA E
INDUSTRIALIZIMIT GJITHËPËRFSHIRËS
DHE TË QËNDRUESHËM DHE NXITJA E
NOVACIONIT





- 9.1 Të zhvillohet një infrastrukturë cilësore, e sigurt, e qëndrueshme dhe rezistente, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve, me fokus qasjen e përballueshme dhe të barabartë për të gjithë.
- 9.2 Të përkrahet industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe, deri në vitin 2030, të rritet në mënyrë të konsiderueshme pjesa e industrisë së punësimit dhe e prodhimit të brendshëm bruto, në përputhje me kushtet e vendit dhe të dyfishohet kontributi i këtij sektori në vendet më pak të zhvilluara.
- 9.3 Të rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla industriale dhe e ndërmarrjeve të tjera, në veçanti në vendet në zhvillim, tek shërbimet financiare, duke përfshirë kredi të përballueshme, dhe integrimi i tyre në zinxhirët e vlerave dhe të tregjeve.
- 9.4 Deri në vitin 2030, të përmirësohet infrastruktura dhe industria e rikonstruksionit termik, për t'i bërë ato të qëndrueshme, me eficiencë të rritur në burimet e përdorura dhe miratim më i madh i teknologjive dhe proceseve industriale të pastra dhe të shëndetshme për mjedisin, ku të gjitha vendet duhet të ndërmarrin veprime në përputhje me aftësitë dhe kapacitetet e tyre përkatëse.
- 9.5 Të forcohet kërkimi shkencor, të përmirësohen aftësitë teknologjike të sektorëve industrialë në të gjithë vendet, e në veçanti në vendet në zhvillim, përfshirë që deri në vitin 2030, të nxitet risia dhe qëndrueshmëria duke rritur ndjeshëm numrin e punonjësve që merren me kërkimin dhe zhvillimin për 1 milion banorë dhe shpenzimet publike dhe private për kërkim-zhvillimin.
- 9.a Të lehtësohet zhvillimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe rezistente në vendet në zhvillim përmes forcimit të mbështetjes financiare, teknologjike dhe mbështetjes teknike për vendet e Afrikës, vendet më pak të zhvilluara, vendet pa dalje në det dhe shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim.
- 9.b Përkrahja e zhvillimit të teknologjisë brenda secilit shtet, nxitja e kërkimit dhe inovacioni në vendet në zhvillim, duke përfshirë dhe duke siguruar një mjedis të favorshëm politikash, ndërmjet të tjerash, diversifikimi industrial dhe vlera shtesë për mallrat e konsumit;
- 9.c Të rritet në mënyrë të konsiderueshme qasje në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit dhe përpjekjet për të siguruar një qasje të gjithanshme dhe të përballueshme në internet në vendet më pak të zhvilluara, deri në vitin 2020.

10

ZVOGËLIMI I PABARAZIVE



ZVOGËLIMI I PABARAZISË BRENDA
ÇDO VENDI DHE NDËRMJET SHTETEVE


- 
- 10.1 Deri në vitin 2030, të arrihet në mënyrë progresive dhe të ruhet ritmi i rritjes të të ardhurave për 40 % të shtresës më të varfër të popullsisë me një ritëm më të lartë se ritmi i mesatares kombëtare.
 - 10.2 Deri në vitin 2030, të fuqizohet dhe të përkrahet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike e të gjithë njerëzve, pavarësisht moshës, gjinisë, paaftësisë, racës, kombësisë, origjinës, besimit apo gjendjes ekonomike apo ndonjë statusi tjetër social.
 - 10.3 Të sigurohen mundësi të barabarta dhe të zvogëlohen pabarazitë e rezultateve, përfshirë përmes eliminimit të ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimit në këtë drejtim të legjislacionit, politikave dhe veprimeve të përshtatshme.
 - 10.4 Të miratohen politika, sidomos ato fiskale, politika të pagave dhe të mbrojtjes sociale, dhe të arrihet në mënyrë progresive barazi më e madhe.
 - 10.5 Të përmirësohen rregullat dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe të forcohet zbatimi i rregulloreve përkatëse.
 - 10.6 Të sigurohet një përfaqësim më i fortë dhe të dëgjohet zëri i vendeve në zhvillim në vendimmarrjen e institucioneve ndërkombëtare ekonomike dhe financiare, me qëllim krijimin e institucioneve më efektive, më të besueshme, më të përgjegjshme dhe legjitime.
 - 10.7 Të lehtësohet migracioni dhe lëvizja e njerëzve e organizuar, e sigurt, e rregullt dhe e përgjegjshme, përfshirë edhe përmes zbatimit të politikave të planifikuara dhe të mirëmenaxhuara për migrimin.
 - 10.a Të zbatohen parimet e trajtimit të veçantë dhe të diferencuar për vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me marrëveshjet e Organizatës Botërore të Tregtisë.
 - 10.b Të nxitet ndihma zyrtare për zhvillim dhe lëvizjet financiare, përfshirë investimet e huaja direkte, për shtetet ku nevoja është më e madhe, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, vendet afrikane, shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim dhe vendet në zhvillim pa dalje në det, në përputhje me planet dhe programet e tyre kombëtare.
 - 10.c Deri në vitin 2030, të zvogëlohet në më pak se 3 % kostoja e transaksionit të dërgesave të emigrantëve dhe të eliminohen korridoret e dërgesave me kosto më të lartë se 5 %.
- 

11

QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME



NDËRTIMI I QYTETEVE DHE
VENDBANIMEVE GJITHËPËRFSHIRËS,
TË PARREZIKSHËM, REZISTENTË DHE TË
QËNDRUESHËM



- 11.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë njerëzit qasje për strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe në shërbime bazë dhe të përmirësohet situata në lagjet e varfëra.
- 11.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.
- 11.3 Deri në vitin 2030, të zgjerohet urbanizimi në nivel gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të forcohen kapacitetet për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve të qëndrueshme, përfshirëse dhe pjesëmarrëse, në të gjitha vendet.
- 11.4 Të forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.
- 11.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta, lidhur me prodhimin e brendshëm bruto në nivel global, të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë dhe fatkeqësitë që lidhen me ujin, me fokus mbrojtjen e shtresave të varfëra dhe të njerëzve në gjendje të pambrojtur.
- 11.6 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera.
- 11.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e gjithëanshme në hapësirat publike të gjelbra, të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, në veçanti për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
- 11.a Të mbështeten lidhjet pozitive ekonomike, sociale dhe mjedisore ndërmjet zonave urbane, ndër-urbane dhe rurale duke forcuar planifikimin për zhvillim në nivel kombëtar dhe rajonal.



- 11.b Deri në vitin 2020, të rritet ndjeshëm numri i qyteteve dhe i vendbanimeve, duke miratuar dhe zbatuar politika dhe plane të integruara drejt gjithëpërfshirjes, eficiencës së burimeve, marrjes së masa për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, aftësisë ripërtëritëse ndaj katastrofave, dhe të zhvillohet e të zbatohet, në përputhje me Kornizën Kuadër të Sendai-it për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore 2015-2030, menaxhimi holistik i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në të gjitha nivelet.
- 11.c Të mbështeten vendet më pak të zhvilluara, përfshirë edhe përmes ndihmës teknike dhe financiare, për ndërtimin e banesave të qëndrueshme dhe rezistente duke përdorur materiale vendase.

Të duash do të thotë të bësh gjëra të vogla me dashuri të madhe.


Nënë Tereza



12 KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM



SIGURIMI I MODELEVE TË
QËNDRUESHME TË KONSUMIT DHE TË
PRODHIMIT



- 12.1 Të gjitha vendet të marrin masa për zbatimin e kornizës kuadër 10 vjeçare të programeve për konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, ku vendet e zhvilluara të ndër marrin rolin udhëheqës, duke patur parasysh zhvillimin dhe aftësitë e vendeve në zhvillim.
- 12.2 Deri në vitin 2030, të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi eficient i burimeve natyrore.
- 12.3 Deri në vitin 2030, të përgjysmohen mbetjet ushqimore për frymë në nivel global, për të arritur në nivelet e shitjes me pakicë dhe të konsumatorit dhe të zvogëlohen humbjet e ushqimit përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe të furnizimit, duke përfshirë dhe humbjet pas korrjeve.
- 12.4 Deri në vitin 2020, të arrihet menaxhimi i shëndetshëm mjedisor i kimikateve dhe i të gjitha mbetjeve gjatë ciklit të tyre të jetës, në përputhje me kornizat kuadër ndërkombëtare të miratuara, dhe të zvogëlohet ndjeshëm shkarkimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, me qëllim zvogëlimin e ndikimeve negative mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
- 12.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm krijimi i mbetjeve përmes zbatimit të parimeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe të ripërdorimit.
- 12.6 Të nxiten kompanitë, veçanërisht kompanitë e mëdha ndërkombëtare, të zbatojnë praktika të qëndrueshme dhe të përfshijnë informacion të qëndrueshëm në ciklin e tyre të raportimit.
- 12.7 Të përkrahen praktika të prokurimit publik që janë të qëndrueshme, në përputhje me politikat dhe prioritetet kombëtare.
- 12.8 Deri në vitin 2030, të sigurohet që njerëzit të marrin informacionin e duhur dhe të ndërgjegjësohen për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën.
- 12.a Të mbështeten vendet në zhvillim për të forcuar kapacitetet e tyre shkencore dhe teknologjike drejt modeleve më të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit.



- 12.b Të zhvillohen dhe të zbatohen mjetet për të monitoruar ndikimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm për turizëm të qëndrueshëm, duke krijuar vende pune dhe përkrahur kulturën dhe prodhimet vendase.
- 12.c Të racionalizohen subvencionet joefikase për karburantet fosile që nxisin konsumin e panevojshëm duke eleminuar çrregullimet e tregut, në përputhje me kushtet e vendit, përfshirë dhe ristrukturimin e sistemit të taksave dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të këtyre subvencioneve të dëmshme, aty ku ato ekzistojnë, për të pasqyruar ndikimet e tyre në mjedis, duke marrë në konsideratë nevojat dhe kushtet e veçanta të vendeve në zhvillim dhe duke minimizuar ndikimet e mundshme negative gjatë zhvillimit të tyre, në atë mënyrë që të mbrojnë të varfërit dhe komunitetet e prekura.

*Sa më tepër kemi, aq më tepër jemi të zënë, aq më pak japim.
Por sa më pak kemi, aq më të lirë jemi, aq më shumë japim.*


Nënë Tereza



13 VEPRIM PËR KLIMËN



MARRJA E MASAVE URGJENTE PËR TË
LUFTUAR NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE
EFEKTET E TYRE


- 
- 13.1 Të forcohen aftësitë ripërtëritëse dhe përshtatëse ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet.
 - 13.2 Masat për ndryshimet klimatike të përfshihen në politikat, strategjitë dhe planet kombëtare.
 - 13.3 Të përmirësohet edukimi, rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale lidhur me zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen ndaj tyre, zvogëlimin e ndikimeve dhe paralajmërimin e hershëm.
 - 13.a Të zbatohet angazhimi i marrë nga shtetet e zhvilluara, palë të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, drejt qëllimit të mobilizimit të përbashkët të një fondi prej 100 miliardë US\$ çdo vit, deri në vitin 2020, nga të gjitha burimet, për të adresuar nevojat e vendeve në zhvillim në kuadër të masave kuptimplotë zbutëse dhe të transparencës në zbatimin dhe vënien në funksionim të plotë të Fondit të Gjelbër për Klimën përmes kapitalizimit të tij sa më shpejt të jetë e mundur.
 - 13.b Të përkrahen mekanizmat për ngritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim efektiv lidhur me ndryshimet klimatike në vendet më pak të zhvilluara dhe në shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim, përfshirë dhe fokusimin tek gratë, të rinjtë dhe komunitetet vendore dhe të margjinalizuara.

*Fjalët e mira mund të jenë të shkurtra
dhe të lehta për t'u thënë,
por jehona e tyre është vërtet pa fund.*
Nënë Tereza


**Duke pranuar që Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike është forumi kryesor ndërkombëtar e ndërqeveritar për të negociuar mbi përgjigjen globale ndaj ndryshimeve klimatike*



14 JETA NËN UJË



RUAJTJA DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I
OQEA NEVE, DE TEVE DHE BURIMEVE DETARE
PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM




- 14.1 Deri në vitin 2025, të parandalohet dhe të zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme ndotja detare e të gjitha llojeve, në mënyrë të veçantë nga aktivitetet tokësore, përfshirë mbetjet detare dhe ndotjen nga lëndët ushqyese.
- 14.2 Deri në vitin 2020, të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të mbrohen ekosistemet detare dhe bregdetare për të shmangur ndikimet negative domethënëse, përfshirë përmes forcimit të aftësive ripërtëritëse, dhe të merren masa për rehabilitimin e tyre me qëllimin për të patur oqeanë të shëndetshëm e produktivë.
- 14.3 Të minimizohen dhe të adresohen ndikimet e acidifikimit të oqeanëve, përfshirë edhe përmes rritjes së bashkëpunimit shkencor në të gjitha nivelet.
- 14.4 Deri në vitin 2020, të rregullohet në mënyrë efektive peshkimi dhe t'i jepet fund mbipeshkimit, peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar dhe praktikave të dëmshme në peshkim dhe të zbatohen plane menaxhimi me bazë shkencore në mënyrë që të recuperohen rezervat e peshqve për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivelin që të mund të arrihet prodhimi maksimalë e qëndrueshme, siç është përcaktuar prej karakteristikave të tyre biologjike.
- 14.5 Deri në vitin 2020, të mbrohen të paktën 10 % e zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të bazuara në informacionin më të mirë shkencor të mundshëm.
- 14.6 Deri në vitin 2020, të ndalohen disa forma të subvencioneve në peshkim, të cilat ndikojnë në tejkalimin e kapacitetit dhe mbipeshkimin, të eliminohen subvencionet që ndikojnë në peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregullt dhe të frenohet futja e subvencioneve të reja të këtij lloji, duke pranuar që një trajtim i ndryshëm, i përshtatshëm, efektiv dhe i veçantë duhet të jetë pjesë përbërëse e negociatave të Organizatës Botërore të Tregëtisë për subvencionet e peshkimit për vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara.
- 14.7 Deri në vitin 2030, të rriten përfitimet ekonomike nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve detare në shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim dhe në vendet më pak të zhvilluara, përfshirë edhe përmes menaxhimit të qëndrueshëm të peshkimit, akuakulturës dhe turizmit.



- 14.a Të rriten njohuritë shkencore, të zhvillohen kapacitetet kërkimore dhe të transferohet teknologjia detare, duke marrë parasysh Kriteret dhe Udhëzimet e Komisionit Ndërqeveritar Oqeanografik për Transferimin e Teknologjisë Detare, me qëllim përmirësimin e gjendjes së oqeanit dhe forcimin e ndikimit të biodiversitetit detar në zhvillimin e vendeve në zhvillim, e në veçanti të shteteve- ishuj të vegjël në zhvillim dhe të vendeve më pak të zhvilluara.
- 14.b Për ndërmarrjet e vogla artizanale të peshkimit të sigurohet qasja në infrastrukturën detare dhe tregjet.
- 14.c Të rritet mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve dhe i burimeve të tyre duke zbatuar ligjin ndërkombëtar siç pasqyrohet në UNCLOS, i cili siguron kuadrin ligjor për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të oqeanëve dhe të burimeve të tyre, sikurse parashikohet në paragrafin 158 të dokumentit "E ardhmja që ne duam".

*Unë nuk mund të ndryshojë botën i vetëm,
por unë mund të hedh një gur në ujë
për të krijuar më shumë rrathë.*


Nënë Tereza



15 JETA NË STERE



MBROJTJA, REHABILITIMI DHE PROMOVIMI I PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM TË EKOSISTEMEVE TOKËSORE, MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I PYJEVE, LUFTA KUNDËR SHKRETËTIRËZIMIT, NDALIMI E KTHIMI MBRAPA I PROCESIT TË DEGRADIMIT TË TOKËS DHE NDALIMI I HUMBJES SË BIODIVERSITETIT



- 15.1 Deri në vitin 2020, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe i ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe shërbimet e tyre, veçanërisht pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.
- 15.2 Deri në vitin 2020, të promovohet zbatimi i menaxhimit të qëndrueshëm i të gjitha llojeve të pyjeve, ndalimi i shpyllëzimit, rehabilitimi i pyjeve të degraduar dhe rritja e qëndrueshme e pyllëzimit dhe ripyllëzimi në nivel global.
- 15.3 Deri në vitin 2030, të luftohet shkretëtirëzimi, rehabilitimi i tokës së degraduar, përfshirë dhe tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmytjet, dhe të synohet ndalimi i degradimit të tokës.
- 15.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet ruajtja e ekosistemeve malore, përfshirë dhe biodiversitetin e tyre, në mënyrë që të rriten kapacitetet e tyre për të siguruar përfitime thelbësore për Zhvillimin e Qëndrueshëm.
- 15.5 Të ndërmerren masa urgjente dhe të rëndësishme për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore, ndalimin e humbjes së biodiversitetit dhe, deri në vitin 2020, të mbrohet dhe të parandalohet zhdukja e llojeve të kërcënuar.
- 15.6 Të përkrahët ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike dhe të promovohet qasja e duhur në këto burime, siç është rënë dakord ndërkombëtarisht.
- 15.7 Të merren masa urgjente për t'i dhënë fund gjuetisë ilegale dhe trafikimit të llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës dhe të adresohen si kërkesa dhe furnizimi i tregut me produkte ilegale të jetës së egër.
- 15.8 Deri në vitin 2020, të paraqiten masat për të parandaluar futjen e llojeve invazive dhe të zvogëlohet ndjeshëm ndikimi i tyre në ekosistemet tokësore dhe ujore dhe të kontrollohen ose të zhduken llojet me ndikim më të madh.
- 15.9 Deri në vitin 2020, të përfshihen vlerat e ekosistemit dhe të biodiversitetit në planifikimin kombëtar dhe vendor, në proceset e zhvillimit, në strategjitë dhe raportimet për uljen e varfërisë.



- 15.a Të aktivizohen dhe të rriten në mënyrë të konsiderueshme fondet financiare nga të gjithë burimet për të ruajtur dhe për të përdorur në mënyrë të qëndrueshme biodiversitetin dhe ekosistemet.
- 15.b Të aktivizohen fonde të rëndësishme nga të gjitha burimet dhe në të gjitha nivelet për të financuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për të ofruar stimujt e përshtatshëm për vendet në zhvillim për të ecur përpara në menaxhim, përfshirë dhe ruajtjen e ripyllëzimin.
- 15.c Të rritet mbështetja globale në përpjekjet për të luftuar gjuetinë e paligjshme dhe trafikimin e llojeve të mbrojtura, duke përfshirë dhe rritjen e kapacitetit të komuniteteve vendore për të mundësuar një jetesë të qëndrueshme.

Pemët, lulet dhe bari rriten në qetësi.


Yjet, dielli dhe hëna lëvizin në qetësi.

Qetësia u jep vizion gjërave.


Nënë Tereza



16 PAQE, DREJTËSI, IN- STITUCIONE TË FORTA



PROMOVIMI I SHOQËRIVE NË PAQE DHE
GJITHËPËRFSHIRËSE PËR NJË ZHVILLIM
TË QËNDRUESHËM, SIGURIA E QASJES NË
DREJTËSI PËR TË GJITHË, DHE NDËRTIMI
I INSTITUCIONEVE GJITHËPËRFSHIRËSE,
LLOGARIDHËNËSE EEFKTIVE
NË TË GJITHA NIVELET


- 
- 16.1 Kudo të zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës.
 - 16.2 T'i jepet fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe të torturës ndaj fëmijëve.
 - 16.3 Të përkrahet sundimi i ligjit në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të gjithë njerëzit të sigurohen të drejta të barabarta për t'iu drejtuar gjykatës.
 - 16.4 Deri në vitin 2030, të zvogëlohen ndjeshëm lëvizjet e paligjshme financiare dhe lëvizjet e armëve, të forcohet rigjetja dhe rikthimi i pasurive të vjedhura dhe të luftohen të gjitha format e krimit të organizuar.
 - 16.5 Të zvogëlohet ndjeshëm korrupsioni dhe ryshfeti në të gjitha format e tyre.
 - 16.6 Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet.
 - 16.7 Të sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.
 - 16.8 Të zgjerohet dhe të forcohet pjesëmarrja e vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale.
 - 16.9 Deri në vitin 2030, të sigurohet identiteti ligjor për të gjithë njerëzit, duke përfshirë regjistrimin e lindjes.
 - 16.10 Të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.
 - 16.a Të fuqizohen institucionet përkatëse kombëtare, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.
 - 16.b Të përkrahen dhe të forcohen ligjet dhe politikat jo diskriminuese për Zhvillim të Qëndrueshëm.

*Çfarë mund të bëni për të promovuar paqen në botë?
Shkoni në shtëpi dhe duajeni familjen.*


Nënë Tereza



17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT



FUQIZIMI I MJETEVE TË ZBATIMIT DHE TË
RIGJALLËRIMIT TË PARTNERITETIT GLOBAL
PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



Financat

- 17.1 Të forcohet aktivizimi i burimeve të brendshme, përfshirë edhe përmes mbështetjes ndërkombëtare për vendet në zhvillim, për të përmirësuar kapacitetin e brendshëm për mbledhjen e taksave dhe të të ardhurave të tjera.
- 17.2 Vendet e zhvilluara të përmbushin zotimet e tyre zyrtare për të ndihmuar zhvillimin, përfshirë dhe angazhimin nga shumë vende të zhvilluara për të arritur objektivin e 0.7 % të Ndhmës Zyrtare për Zhvillim ndaj të Ardhurave Kombëtare Bruto (ODA/GNI) për vendet në zhvillim dhe 0.15 deri në 0.20 % të ODA/GNI për vendet më pak të zhvilluara; ofruesit e Ndhmës Zyrtare për Zhvillim (ODA) nxiten të marrin në konsideratë vendosjen e një objektivi për të siguruar të paktën 0.20 % të ODA/GNI për vendet më pak të zhvilluara.
- 17.3 Të aktivizohen fonde shtesë financiare për vendet në zhvillim nga disa burime të ndryshme.
- 17.4 Të ndihmohen vendet në zhvillim në arritjen e qëndrueshmërisë së borxhit afatgjatë përmes politikave të koordinuara që synojnë nxitjen e financimit të borxhit, lehtësimin e borxhit dhe, ku është e nevojshme, ristrukturimin e borxhit, dhe adresimin e duhur të borxhit të jashtëm të vendeve të varfra me borxhe të larta për të zvogëluar ankthin e borxhit.
- 17.5 Të miratohen dhe të zbatohen praktika për përkrahjen e investimeve për vendet më pak të zhvilluara.

Teknologjia

- 17.6 Të rritet bashkëpunimi rajonal, bashkëpunimi ndërkombëtar, bashkëpunimi veri-jug, bashkëpunimi jug-jug dhe bashkëpunimi trekëndor për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe qasja në to, dhe të forcohet shkëmbimi i njohurive për kushte të rëna dakord reciprokisht, përfshirë edhe përmes koordinimit të përmirësuar ndërmjet mekanizmave ekzistues, në veçanti në nivelin e Kombeve të Bashkuara, dhe përmes mekanizmit global lehtësues për teknologjinë.
- 17.7 Të promovohet zhvillimi, transferimi, shpërndarja dhe përhapja e teknologjive miqësore me mjedisin për vendet në zhvillim, mbi kushte të favorshme, përfshirë këtu kushtet lehtësuese dhe preferenciale, siç është rënë dakord reciprokisht.



17.8 Të vihet në funksionim të plotë Shkenca dhe Arkiva e Teknologjisë, mekanizmi për ngritjen e kapaciteteve për inovacion dhe teknologji për vendet më pak të zhvilluara, deri në vitin 2017, dhe të forcohet përdorimi i teknologjisë ku është e mundur, dhe në veçanti i teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit. Rritja e bashkëpunimit rajonal, ndërkombëtar, Veri-Jug, Jug-Jug dhe trekëndor për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe qasjen në to, përmirësimi i ndarjes së njohurive sipas termave për të cilat është rënë dakord reciprokisht, duke përfshirë përmirësimin e koordinimit ndërmjet mekanizmave ekzistues, veçanërisht në nivelin e Kombeve të Bashkuara, dhe nëpërmjet mekanizmit global lehtësues për teknologjinë;

Ngritja e kapaciteteve

17.9 Të forcohet mbështetja ndërkombëtare për zbatimin e programeve efektive dhe të targetuara në ngritjen e kapaciteteve për vendet në zhvillim në mbështetje të planeve kombëtare për të zbatuar të gjitha objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit veri-jug, jug-jug dhe atij trekëndor.

Tregtia

17.10 Të përkrahet ngritja e një sistemi tregtie shumëpalëshe, të gjithëanshme, të bazuar në rregulla, të hapur, jo diskriminuese dhe të barabartë, sipas Organizatës Botërore të Tregtisë, përfshirë edhe përmes përfundimit të negociatave sipas Axhendës së Zhvillimit Doha.

17.11 Të rriten ndjeshëm eksportet e vendeve në zhvillim, duke synuar, në veçanti, dyfishimin e pjesës së eksporteve globale të vendeve më pak të zhvilluara, deri në vitin 2020.

17.12 Të realizohet në kohën e duhur qasja në tregun e çliruar nga detyrimet dhe pa kuota mbi një bazë të qëndrueshme për të gjitha vendet më pak të zhvilluar, në përputhje me vendimet e Organizatës Botërore të Tregtisë, përfshirë dhe sigurimin që rregullat preferenciale të origjinës të zbatueshme për importet nga vendet më pak të zhvilluara, të jenë transparente, të thjeshta dhe të ndikojnë në lehtësimin e qasjes në treg.

Çështjet sistematike

Politika dhe koherenca institucionale

- 17.13 Të rritet qëndrueshmëria globale makroekonomike, përfshirë edhe përmes koordinimit të politikave dhe bashkëpunimit institucional.
- 17.14 Të rritet bashkëpunimi politik për Zhvillimin e Qëndrueshëm.
- 17.15 Të respektohet hapësira politike dhe roli udhëheqës i çdo vendi për të vendosur dhe për të zbatuar politikat për çrrënjosjen e varfërisë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Partneritet shumëpalësh

- 17.16 Të rritet partneriteti global për Zhvillim të Qëndrueshëm, plotësuar nga një partneritet shumëpalësh që aktivizon dhe shkëmben njohuri, ekspertizë, teknologji dhe burime financiare, për të mbështetur arritjen e objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet, e në veçanti në vendet në zhvillim.
- 17.17 Të nxitet dhe të përkrahet partneriteti publik efektiv, partneriteti publik-privat dhe partneriteti i shoqërisë civile, i ngritur mbi përvojën, burimet dhe strategjitë e partneritetit.

Të dhënat, monitorimi dhe përgjegjshmëria

- 17.18 Deri në vitin 2020, të forcohet mbështetja për ngritjen e kapaciteteve në vendet në zhvillim, përfshirë edhe vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim, për të rritur ndjeshëm disponueshmërinë e të dhënave cilësore, të përditësuara dhe të besueshme të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, kombësisë, statusit migrues, paaftësisë, vendndodhjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera përkatëse në kontekstin kombëtar të çdo vendi.
- 17.19 Deri në vitin 2030, të ngrihet mbi nismat ekzistuese për të zhvilluar masa të progresit për Zhvillimin e Qëndrueshëm që plotësojnë prodhimin e brendshëm bruto dhe mbështetjen ngritjen e kapaciteteve statistikore në vendet në zhvillim.



